

VENDIM
Nr. 317, datë 27.4.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PUBLIK QË PËRFAQËSON SHTETIN SI
PRONAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, e 53, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon menjëherë pranë Entit Rregullator të Energjisë, për certifikim, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 58, të ligjit nr. 43/2015.

5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi OST-në, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe fushën e tij të përgjegjësisë shtetërore.

6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Korporata Elektro-energjetike Shqiptare, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama